



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT RAJONAL PËR VITIN 2022

Prishtinë, qershor 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal (MZHR), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të MZHR kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Zv. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Zv. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë pëmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Zhvillimit Rajonal është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal me kriteret e përcaktuara të auditimit që

burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat për përmirësim janë identifikuar tek stoqet, subvencionet dhe tek procedura e prokurimit që ndërlidhet me angazhimin e konsulentëve.

Ky raport ka rezultuar me 3 (tre) rekomandime të reja.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

MZHR është përgjegjëse për vendosjen e kontrolleve të brendshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare.

Çështja A1 - Mbivlerësim i stoqeve në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV)

Gjetja

Sipas nenit 19 pika 3 të rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, raportet për pasuritë që paraqiten nga organizatat buxhetore përfshijnë: 3.1. Pasuritë kapitale që kanë vlerë mbi 1,000€ të regjistruara në SIMFK; 3.2. Pasuritë jo kapitale që kanë vlerë deri 1,000€ të regjistruara në "e – pasuria"; dhe 3.3. Stoqet.

Vlera e stoqeve e prezantuar në PFV ishte 52,934€, përderisa vlera në sistemin e-pasuria ishte 3,325€ e cila do të duhej të paraqitej edhe në PFV. Si rezultat i kësaj kemi mbivlerësim të stoqeve në PFV për 49,609€.

Mbivlerësimi i stoqeve në PFV ishte ndikuar nga paqartësitë e zyrtarëve përgjegjës gjatë nxjerrjes së informatave nga sistemi e-pasuria për stoqet. Krahas vlerës së stoqeve ishte prezantuar edhe vlera e materialit tashmë në përdorim.

Ndikimi

Paraqitja e të dhënave të gabuara mbi stoqet ka ndikuar në prezantimin jo të drejtë të gjendjes së stoqeve në PFV.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të sigurojë se kontrollet në zyrën e financave janë efektive në mënyrë që të bëhet prezantim i drejtë i të dhënave dhe që gabimet e tilla të mos përsëriten gjatë përgatitjes së Pasqyrave Financiare të vitit 2023.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2022 ishte 246,860€, prej tyre ishin shpenzuar 187,300€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese tjera, karburante për vetura, etj.

Çështja A2 - Angazhimi i konsulentëve përmes procedurave të prokurimit për mbulimin e pozitive të rregullta

Gjetja Sipas Rregullave për prokurim të shërbimeve të veçanta (Konsulentët/Kontraktorët individual), tek neni 3.1 përcaktohet se këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilët nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit sipas Ligjit për Zyrtaret Publik nr. 06-L-114. Shërbimet e veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit janë shërbimet profesionale për të cilat Autoriteti Kontraktuese ka nevojë por që nuk i plotëson kërkesat me stafin që e ka. Më tej, neni 3.2 përcakton se Konsulenti/Kontraktori individual është një specialist në një fushë specifike, i angazhuar nga Autoriteti Kontraktues në rolin e një këshilluesi.

Gjatë vitit 2022 ministria kishte angazhuar shtatë konsulent përmes procedurave të prokurimit për periudhë një vjeçare. Ne kemi testuar dy raste në vlerë të përbashkët 9,480€. Prokurimi i shërbimeve të veçanta ishte bërë për "Konsulent individual për monitorim të projekteve të MZHR-së" dhe "Konsulent për menaxhim dhe implementim të projekteve". Pozitat e mbuluara me konsulent janë pozita të rregullta të punës në kuadër të ministrisë të cilat është dashur të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit.

Mos aplikimi i procedurave të duhura të angazhimit të personelit për nevojat e ministrisë ishte ndikuar nga kufizimet në shpalljen e konkurseve të jashtme, dhe pamjaftueshmëria e personelit të angazhuar në raport me detyrat dhe përgjegjësitë që ka kjo ministri.

Ndikimi Duke pas parasysh rëndësinë dhe specifikat e implementimit të projekteve mbulimi i pozitive të rregullta të punës përmes procedurave të prokurimit rrezikon që monitorimi i tyre të mos bëhet sipas kushteve të parapara në kontratë.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të siguroj se në bashkëpunim me MFTP do të gjej një zgjidhje të qëndrueshme lidhur me plotësimin e nevojave të ministrisë për personel shtesë, kështu pozitat e rregullta të punës të përfshihen në planin e rekrutimeve, dhe të sigurohet rekrutimi i personelit të nevojshëm përmes procedurave të rekrutimit në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e ministrisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere në 2022 ishte 3,525,000€, prej tyre ishin shpenzuar 3,509,326€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me financimet e bizneseve dhe ndërmarrësve të rinj nga programi i zhvillimit rajonal të balancuar për krijimin e vendeve të reja të punës.

Çështja A3 - Mos zbatimi i kriterit për krijimin e vendeve të reja të punës

Gjetja

Sipas nenit 9 të Udhëzimit Administrativ 01/2018 për kushtet dhe kriteret e përkrahjes së bizneseve /ndërmarrësve të rinj nga Programi për Zhvillim Rajonal i Balancuar, të gjithë përfituesit, të cilët në planin e tyre të biznesit kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës dhe për këtë kanë fituar pikë gjatë vlerësimit, duhet t'i krijojnë ato dhe të dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimit në paga duke filluar së paku nga muaji i fundit para kërkesës për pagesën e fundit. Përfituesit janë të obliguar ti mbajnë këto vende pune të plotësuara me punëtorë me orar të plotë për 2 vjet, aq sa zgjat periudha monitoruese. Po ashtu, sipas kontratës në mes MZHR-së dhe përfituesit, neni 3, paragrafi 1.4 si pjesë detyruese të kontratës, përfituesi zotohet se pas implementimit të projekt-propozimit për periudhën dy vjeçare makinerinë/aparaturën e blerë nëpërmjet këtij granti nuk do ta tjetërsojë apo huazojë, sikur që do t'i përmbahet punësimit të numrit të punëtorëve siç i ka prezantuar në aplikacionin e platformës E-Kosova minimalisht për periudhën sa është nën monitorim të MZHR-së.

Për projektet e subvencionuara nga skema e granteve për Programin e Zhvillimit Rajonal të Balancuar, kemi vërejtur se në gjashtë raste për projektet në vlerë të përbashkët 32,233€ nuk ishin paguar tatimet në paga dhe kontributet pensionale të punëtorëve për të cilat kishte deklaruar përfituesi. Obligimet tatimore ishin ekzekutuar për një, përkatësisht dy muaj, përderisa nuk janë ofruar dëshmi se kishin vazhduar të paguhet për aq sa zgjatë periudha monitoruese.

Kjo kishte ndodhur për shkak se ministria nuk kishte vendosur politika të zbatueshme për monitorimin dhe mbikëqyrjen e plotësisht të këtij kriteri gjatë realizimit të projektit.

Ndikimi

Mos përmbushja e kontratës nga përfituesi dhe monitorimi jo i duhur i granteve rrit rrezikun që granti i dhënë të mos e arrij qëllimin e synuar të punësimit.

Rekomandimi A3

Ministri duhet të siguroj se janë përcaktuar politika monitoruese efektive në mënyrë që kriteret e vendosura për përfituesit të zbatohen për tu arritur qëllimi i synuar i përkrahjes së bizneseve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	4,213,901	5,865,348	5,484,703	3,290,343	5,965,143
Grante Qeveritare – Buxheti	4,213,901	5,865,348	5,484,703	3,290,343	5,965,143

Buxheti final i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal ishte më i lartë se buxheti fillestar për 1,651,447€. Kjo rritje e buxhetit është rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje buxhetore në vlerë prej 1,945,000€ dhe kursimeve buxhetore prej 293,553€.

Në vitin 2022, MZHR ka shpenzuar 94% të buxhetit përfundimtar ose 5,484,704€, me një ulje prej 3% në raport me vitin e kaluar. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	4,213,901	5,865,348	5,484,703	3,290,343	5,965,143
Pagat dhe mëditjet	377,541	377,541	365,417	320,479	297,925
Mallrat dhe shërbimet	245,000	245,000	185,849	231,335	213,944
Komunalitë	11,360	1,860	1,451	5,124	5,522
Subvencionet dhe transferet	1,580,000	3,525,000	3,509,326	1,879,198	3,575,953
Investimet Kapitale	1,760,000	1,714,000	1,422,661	854,206	1,871,799
Rezervat	240,000	1,947	0	0	0

MZHR kishte lëvizje buxhetore nëpër kategori. Megjithatë, të gjitha lëvizjet/ndryshimet ishin të mbështetura me vendime përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë. Sqarimet rreth ndryshimeve buxhetore janë shpalosur si në vijim:

- Buxheti fillestar dhe ai final për paga dhe mëditje nuk kishin ndryshime, ndërsa shpenzimi në këtë kategori ishte 97% e buxhetit;

- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar nuk kishte ndryshime, ndërsa për vitin 2022 ekzekutimi i buxhetit tek kjo kategori ishte 76%. Buxheti nuk ishte realizuar në plotësi për shkak të reduktimit të shpenzimeve të ministrisë;


- Buxheti final në raport me atë fillestar për shpenzime komunale ishte më i ulët prej 9,500€. Përgjatë vitit ekzekutimi i buxhetit ishte 78% për këtë kategori. Kjo për shkak se këtë vit kishte reduktim të shpenzimeve të ministrisë në këtë linjë buxhetore;

- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,945,000€. Kjo ishte si rezultat i ndarjes së mjeteve me vendim të Qeverisë lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, Masa 1.7, në vlerë prej 1,700,000€, dhe ndarjes së mjeteve prej 245,000€. Shpenzimi në këtë kategori ishte rreth 100% e buxhetit; dhe

- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 46,000€. Kjo ishte si rezultat i kursimeve buxhetore. Realizimi i buxhetit është në masën prej 83%. Shpenzimi i buxhetit lidhet me progresin e realizimit të projekteve të bashkë financuara me komunat përkatëse.

Buxheti i ndarë për zbatimin e programit për rimëkëmbje ekonomike për vitin 2022 është 1,700,000€, ndërsa shpenzimet ishin 1,690,330€. Ato kanë të bëjnë me mjetet e ndara nga Qeveria për zbatimin e Programit për Rimëkëmbje Ekonomike në kuadër të Masës 1.7 për skemën e granteve për zanatet.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara nga MZHR në 2022 ishin në 7,500€. Ato kanë të bëjnë me konfiskimin e garancioneve bankare të përfituesve që nuk kanë arritur të implementojnë projektin e tyre konform marrëveshjes me MZHR.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	14,072	14,072	7,500	28,225	11,469
Të hyrat jo tatimore	14,072	14,072		6,096	
Të hyrat tjera	0	0	7,500	22,129	11,469

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2021 të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal nuk kishte rekomandime.

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Nora Rashiti, Udhëheqëse e ekipit



Astrit Bllaca, Anëtar i ekipit



Lumturije Sopi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Besim Kamberaj *Për: B. Salari*
(Zv. Sekretar i Përgjithshëm),

Data: 14 Qershor 2023, Prishtinë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikrat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikrat e mira.